

Deklarata Globale e Parimeve Etike të Punës Sociale



IASSW AIETS



1
NJOHJA E
DINJITETIT
NJERËZOR

2
TË
DREJTAT E
NJERIUT

8
PËRDORIMI I
TEKNOLOGJISË
DHE RRJETEVE
SOCIALE

DREJTËSI
SOCIALE DHE
BARAZI

7
TRAJTIMI I
NJERIUT SI
PERSON I
PLOTË

9
INTEGRITETI
PROFESIONAL

4
VETË
VENDOSJE

6
KONFIDENCIALITETI
DHE
PRIVATËSIA

5
PJESËMARRJE

SFIDIMI I DISKRIMINIMIT
NDËRTIMI I SOLIDARITETIT

SFIDIMI I POLITIKAVE TË PADREJTA

RESPEKTI NDAJ DIVERSITETIT
QASJA NË BURIME TË DREJTA

SFIDIMI I PRAKTIKAVE TË PADREJTA

Deklarata Globale e Parimeve Etike të Punës Sociale (IASSW)¹

Përkthyer nga gjuha Angleze nga:

Agmie Osmani, Departamenti Punë Sociale, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës
Yll Rakipi, Departamenti Punë Sociale, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës

Redaktuar nga:

Prof. Asoc. Dr. Vjollca Krasniqi, Departamenti Punë Sociale, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës

Kjo Deklaratë e Parimeve Etike (referuar në këtë tekst si: Deklarata) është e projektuar për të mbështetur aspiratat e punëtorëve socialë² drejt standardeve më të larta të praktikës etike, përmes proceseve të debatit të vazhdueshëm, vetë-reflektimit, gatishmërisë për të trajtuar ambiguitetet dhe për angazhim në procese të pranueshme etike të vendimmarrjes, për të arritur rezultate etike. Çdo njësi e parimeve në këtë Deklaratë duhet lexuar si e ndërlidhur me njëra-tjetrën dhe jo në mënyrë të veçantë apo të ndarë.

Kjo Deklaratë vë theks të veçantë tek vlerësimi dhe respektimi i njerëzve të cilët pranojnë shërbime nga punëtorët socialë. Pranimi i kësaj Deklarate nga edukatorë, studentë, hulumtues dhe punëtorë socialë, nënkupton përkushtimin tonë për të ruajtur vlerat dhe parimet kryesore të profesionit të punës sociale siç janë përcaktuar në këtë Deklaratë. Një Deklaratë e tillë merr kuptim kur reflekton impulsin moral në punën e punëtorëve socialë, me një përkushtim për të mos shkaktuar dëm, për drejtësi sociale, njohjen e dinjitetit njerëzor dhe për të drejtat universale dhe të patjetërsueshme të njeriut.

Duke njohur cënueshmërinë e vetvetes dhe për më shumë të njerëzve me të cilët angazhohemi ose punojmë në emër të tyre, kjo Deklaratë është e projektuar për të siguruar nivele të shumëfishta të përgjegjësisë ndaj: individëve, familjeve, grupeve dhe komuniteteve me të cilat angazhohemi; vetes; organizatave në të cilat punojmë; dhe konteksteve të gjera shoqërore në të cilat edukimi, praktika dhe hulumtimi në punën sociale ndërveprojnë.

Ne njohim nevojën për një shkëmbim konceptual themelor nga vendosja e dinjitetit të njeriut kryesisht brenda kontekstit të autonomisë, në njohjen e ndërvarësisë dhe ndërlidhjes së dinjitetit të njeriut dhe të drejtave të njeriut. Përveç të qenit autonom dhe qenie të pavarura siç përshkruhet nga teoria liberale, si qenie njerëzore jemi të gjithë të përfshirë në shoqëri dhe të varur nga strukturat dhe implikimet e tyre socio-politike, ekonomike dhe kulturore. Cënueshmëria është një

¹ Kjo Deklaratë është: a) rezultat i feedback-ut gjatë konsultimeve; b) përpjekje në kundërvënien të hegjemonisë Perëndimore në praktikën e punës sociale, në arsim dhe kërkime; dhe c) përpjekje drejt një agjende të dekolonializuar.

² Koncepti "punëtor social" përdoret duke përfshirë edukatorët, studentët, hulumtuesit dhe praktikës së punës sociale; dhe kategoritë e punëtorëve socialë, të cilët në kontekste të ndryshme quhen ndryshe, si punonjësi me të rinjtë, praktikantë të zhvillimit të komunitetit, punonjës të kujdesit për fëmijët, zyrtar të dënimeve me kusht dhe zyrtar të mirëqenies sociale, përveç kur këto kategori janë të veçanta dhe të pavarura nga puna sociale dhe mund të kenë kode të tyre etike.

pjesë universale e qenies njerëzore. Kjo nuk zvogëlon rolin që njerëzit kanë në lirinë e tyre në nivel personal dhe politik, dhe përgjegjësinë e sistemeve socio-politike, ekonomike dhe kulturore në sigurimin e zhvillimit dhe mirëqenies.

Punëtorët socialë njohin dimensionin politik të profesionit, si pasojë e fuqisë dhe autoritetit që u besohet nga shteti për të ndërmarrë veprime me ose në emër të njerëzve, brenda kufijëve të parimeve etike të profesionit.

Puna sociale si profesion është dinamik, kritik dhe e angazhuar me njerëzit dhe mjediset e tyre të shumëfishta. Ka një varg vlerash dhe parimesh etike që na informojnë si punëtorë socialë. Ky realitet njihet në Definicionin Global të Punës Sociale të vitit 2014, i cili është shumë shtresor dhe inkurajon plotësim/ndryshimet në nivel rajonal dhe kombëtar. Po ashtu, kjo Deklaratë mund të plotësohet dhe/ose adaptohet në nivele kombëtare dhe/ose rajonale, përderisa është në përputhje me qëllimin dhe frymën e kësaj Deklarate.

Organizatrat të cilat punësojnë punëtorë socialë, institucionet e arsimit dhe hulumtimit duhet të punojnë drejt ofrimit të mundësive infrastrukturore dhe zhvillimore për të lehtësuar arritjen e detyrave etike. Nuk është vetëm detyrë e punëtorit social që të sigurojë praktika etike; organizatat duhet gjithashtu të plotësojnë detyrimet e tyre në mbështetjen e praktikave etike.³

Kjo Deklaratë merr si pikënisje Definicionin Global të Punës Sociale të vitit 2014, i cili parashton si më poshtë:

Puna sociale është profesion i bazuar në praktikë dhe fushë akademike që mundëson ndryshimin dhe zhvillimin social, bashkëpunimin social, fuqizimin dhe lirinë e njerëzve. Parimet e drejtësisë sociale, të drejtave të njeriut, përgjegjësisë kolektive dhe respekti për diversitetet janë jetike për punën sociale. Duke u mbështetur në teoritë e punës sociale, shkencat sociale, humanistike dhe njohuritë vendase, puna sociale angazhon njerëzit dhe strukturat për të adresuar sfidat e jetës dhe për të përmirësuar mirëqenien.

³ Shih Agius, A. & Jones, D. N. (2012). Effective and ethical working environments for social work: The responsibilities of employers of social workers. Bern: International Federation of Social Workers. Marrë nga <http://ifsw.org/policies/effective-and-ethical-working-environmentsfor-social-work-the-responsibilities-of-employers-of-social-workers-3/#.UFvw6fZeOJc.email>

Parimet:

1. Njohja e Dinjitetit Njerëzor

1.1 Duke njohur dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore, punëtorët socialë punojnë drejt marrëdhënieve empatike dhe bëjnë që ekzistenca për *Tjetrit*⁴ (njerëzit me të cilët punëtorët socialë punojnë ose në emër të cilëve punojnë) të jetë një nga themelet e praktikës etike, ku punëtori social i jep *Tjetrit* përparësinë mbi *Veten*. Esenca është të trajtohen të gjithë njerëzit ashtu siç dëshirojnë ata të trajtohen dhe siç do të doja të trajtohesha unë.

1.2 Punëtorët socialë shfaqin respekt për dinjitetin dhe vlerën e të gjitha qenieve njerëzore, në qëndrim, fjalë dhe veprë. Sigurisht duhet të bëhet dallimi mes vlerës pozitive të pandashme të personave dhe qëndrimeve, sjelljeve dhe/ose konteksteve socio-politike dhe kulturore të njerëzve që mund të konsiderohen të nevojshme për ndryshim. Përderisa respekti për njeriun është esencial, ne gjithashtu sfidojmë besimet dhe veprimet e atyre personave të cilët zhvlerësojnë ose stigmatizojnë veten ose personat e tjerë.

1.3 Punëtorët socialë vlerësojnë se nevoja për diferencimin e shpjeguar në 1.2 kërkon praktikë reflektuese kritike. Ashtu si punëtorët socialë (ashtu si edhe njerëzit me të cilët angazhohemi) sjellim në marrëdhënien e punës tonë historitë, dhimbjet dhe gëzimet tona, vlerat, dhe orientimet tona fetare, shpirtërore dhe kulturore. Reflektimi kritik mbi mënyrën si personalja ndikon fushën profesionale dhe anasjelltas duhet të jetë themeli i praktikës etike të përditshme.

1.4 Duke njohur forcën dhe dinjitetin e brendshëm që të gjithë qeniet njerëzore posedojnë, punëtorët socialë pranojnë cënueshmërinë⁵ e inkorporuar të vetes dhe të njerëzve me të cilët punojnë. Përqendrimi, njohja dhe trajtimi i cënueshmërive është themelore për forcën, të cilat mund të shndërrohen në burime të rritjes, zhvillimit dhe lulëzimit njerëzor.

2. Promovimi i të Drejtave të Njeriut

2.1 Punëtorët socialë pranojnë dhe promovojnë të drejtat themelore dhe të paprekshme të të gjitha qenieve njerëzore, siç pasqyrohen në instrumentet dhe konventat për të drejtat e njeriut, si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa për të Drejtat e Fëmijëve; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike dhe Kulturore; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial; Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara; Konventa lidhur me Statusin e Refugjatëve; Deklarata e OKB-

⁴ Koncepti është marrë nga Emmanuel Levinas. Për Levinas, të jesh i përgjegjshëm do të thotë të bësh veten të gatshëm për shërbimin e *Tjetrit* në mënyrë që jeta jote të jetë e lidhur me atë të *Tjetrit*. Justifikimi për Vetveten, për Levinas, fillon me *Tjetrit*; përgjigjet tona ndaj thirrjes së *Tjetrit* na përcaktojnë. Shih Levinas, E. (1985) *Etika dhe Pafundësia* (Përkthyer nga R.A. Cohen). Pittsburgh, PA: Duquesne University Press.

⁵ Të gjithë njerëzit janë qenie të mishëruara; nuk janë qenie të fragmentuara, të izoluara, ku Vetja konsiderohet si e ndarë dhe e pavarur nga rolet që njerëzit i kryejnë. Të gjithë njerëzit mbajnë shkallë të ndryshme të cënueshmërisë. Ky parim sfidon idenë që punëtori social është ekspert, i ndarë dhe neutral, dhe mbështet idenë e një cënueshmërie të përbashkët të mishëruar në gjithë njerëzimin.

së për të Drejtat e Popujve Indigjenë; Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre dhe Standardet Ndërkombëtare të Punës.

2.2 Punëtorët socialë respektojnë dhe mbrojnë parimin e të drejtave të njeriut si të pa ndara, dhe promovojnë të gjitha të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore.

2.3 Duke njohur se kultura ndonjëherë shërben si një maskim për shkeljen e të drejtave të njeriut, punëtorit socialë shërbejnë si ndërmjetësues kulturorë për të mundësuar ndërtimin e një konsensusi, gjetjen e një ekuilibri të përshtatshëm mes të drejtave konkurruese të njeriut, dhe për të ndërmjetësuar për të drejtat e individëve dhe grupeve të personave të marginalizuar, stigmatizuar, të përjashtuar, të shfrytëzuar dhe të shtypur.

2.4 Punëtorët socialë njohin se të drejtat e njeriut duhet të ekzistojnë së bashku me përgjegjësinë kolektive, duke kuptuar se të drejtat individuale të njeriut mund të realizohen vetëm në bazë të përditshme nëse njerëzit marrin përgjegjësi për njëri-tjetrin dhe për mjedisin, dhe nëse punojnë drejt krijimit së marrëdhënieve reciproke në komunitete.

2.5 Punëtorët socialë u ofrojnë njerëzve informacion në lidhje me të drejtat e tyre, dhe mbështesin përpjekjet e njerëzve për të pasur qasje në të drejtat e tyre.

2.6 Punëtorët socialë njohin Shtetin si një aktor kyç në mbrojtjen, promovimin dhe përmbushjen e të drejtave të njeriut.

3. Promovimi i Drejtësisë Sociale

Punëtorët socialë promovojnë drejtësinë sociale, në lidhje me shoqërinë në përgjithësi, dhe në lidhje me njerëzit me të cilët ata punojnë. Kjo do të thotë:

3.1 Sfidimi i Diskriminimit dhe Shypjes Institucionale

a) Punëtorit socialë sfidojnë diskriminimin, i cili përfshin por nuk kufizohet në: aftësitë fizike dhe/ose mendore, aftësisë, moshën, kulturën, identitetin gjinor, orientimin seksual, racën, etninë, gjuhën, besimin fetar, bindjet shpirtërore, pikëpamjet politike, statusin socio-ekonomik, varfërinë, klasën, strukturën familjare, statusin dhe nacionalitetin (ose mungesën e nacionalitetin).

b) Punëtorët socialë njohin se si ideologjia, ligjet, politikat, rregullat, zakonet, ose praktikat mund të krijojnë pabarazi dhe përjashtojnë anëtarët e disa grupeve nga trajtimi i drejtë.

c) Punëtorët socialë punojnë kundër diskriminimit dhe dhunës institucionale në të gjitha format e saj.

3.2 Respekti për Diversitetin

a) Punëtorët socialë punojnë drejt forcimit të komuniteteve gjithpërfshirëse, të cilat respektojnë diversitetin etnik dhe kulturor të shoqërive, duke marrë në konsideratë dallimet individuale, familjare, grupore dhe komunitare.

b) Punëtorët socialë njohin se respekti për, dhe pranimi i diversitetit nuk duhet të përdoret për të shtrirë kufijtë e relativizmit moral, deri në pikën ku të drejtat e disa grupeve të personave, duke përfshirë të drejtën për jetën (p.sh. të grave dhe minoriteteve seksuale, etnike dhe fetare), janë të shkelura. Punëtorët socialë problematizojnë dhe sfidojnë ato praktikat kulturore që kufizojnë gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut.

c) Punëtorët socialë njohin se ndërtimi dhe trajtimi i shqetësimeve socio-ekonomike si çështje kulturore shpesh herë mohon ose zvogëlon faktorët strukturorë themelor që kontribuojnë në sfidat psiko-sociale.

3.3 Qasja e Barabartë në Burime

a) Punëtorët socialë avokojnë dhe punojnë për qasje dhe shpërndarje të drejtë të burimeve dhe pasurisë, duke e njohur se pabarazia dhe e kombinuar me varfërinë paraqesin kërcënime për zhvillimin njerëzor.

b) Punëtorët socialë mbështesin të drejtën e njerëzve për të ardhura të qëndrueshme, të cilat duhet të sigurohen përmes punës së dinjetetshme dhe/ose mbrojtjes sociale universale.

3.4 Kundërshtimi i Politikave dhe Praktikave të Pa Drejta

a) Punëtorët socialë punojnë për të sjellë në vëmendje punëdhënësve të tyre, politikë-bërësve, politikanëve dhe publikut të gjerë situata ku politikat dhe burimet janë të pakënaqshme ose ku politikat dhe praktikat janë të përçmueshme, të padrejta ose të dëmshme. Duke vepruar kështu, punonjësit socialë nuk duhet të ndëshkohen.

b) Punëtorët socialë duhet të jenë të vetëdijshëm për situatat që mund të kërcënojnë sigurinë dhe sigurinë e tyre dhe ata duhet të bëjnë zgjedhje të kujdesshme në këto rrethana. Punëtorët socialë nuk janë të detyruar të veprojnë kur ata mund të vendosin veten e tyre në rrezik.

c) Organizatat globale si IASSW dhe IFSW, në bashkëpunim me Punëtorët socialë, punëdhënësit e tyre dhe/ose organizatat profesionale/statutore kombëtare, kanë një detyrim për të mbrojtur punëtorët socialë që janë të kërcënuar në linjën e detyrës, për shkak të mendimeve të tyre ose kur ata tërheqin vëmendjen rreth padrejtësive.

3.5 Ndërtimi i Solidaritetit

Punëtorët socialë së bashku me kolegët e tyre punojnë aktivisht në komunitete, brenda dhe jashtë profesionit, për të ndërtuar rrjetet e solidaritetit për të punuar drejt ndryshimeve transformuese dhe shoqërive të integruara dhe të përgjegjshme.

4. Promovimi i të Drejtës për Vetëvendosje

4.1 Punëtorët socialë njohin njerëzit si të aftë dhe me fuqi për vetëvendosje.

4.2 Punëtorët socialë respektojnë dhe promovojnë të drejtën e njerëzve për të bërë zgjedhjet dhe vendimet e tyre, nëse kjo nuk kërcënon të drejtat dhe interesat legjitime të të tjerëve.

4.3 Punëtorët socialë njohin se ndërsa individët kanë të drejtën për vetëvendosje dhe kanë lirinë për të menduar - si liri fundamentale - që nuk mund të merret, liria për të menduar nuk garanton ushtrimin e vetëvendosjes.

4.4 Punëtorët socialë njohin se supozimi i marrë si i mirëqënë për të drejtën për vetëvendosje në shumë kontekste shpesh mohojnë faktorët e caktuar socio-kulturorë, ekonomikë dhe politikë që janë përçmues, marginalizues, eksploatues, dhunues dhe përjashtues për zhvillimin njerëzor dhe funksionim.

4.5 Punëtorët socialë njohin realitetet e njerëzve, të cilëve vetëvendosja shpesh iu kufizohet për shkak të faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë funksionet e kontrollit që Punëtorët socialë ushtrojnë në fusha si mbrojtja dhe mirëqenia e fëmijëve, drejtësia penale, aftësia dhe shëndeti mendor.

4.6 Punëtorët socialë njohin se veprimtaria e individëve ndërlidhet me kushtet strukturore, dhe se ideali për vetëvendosje kërkon burime si në arsim të mirë, punë të mirë, qasje në kujdes shëndetësor, strehim të sigurt dhe stabil, siguri dhe mbrojtje, higjienë adekuate, ujë të pastër, mjedis pa ndotje dhe qasje në informacion.

4.7 Punëtorët socialë njohin se diskursat dhe praktikat socio-politike dhe kulturore dominante kontribuojnë në shumë supozime dhe kufizime të cilat marrin si të mirëqena, dhe shfaqen në normalizimin dhe natyralizimin e një sërë paragjykimeve, përçmimeve, marginalizimeve, eksploatimeve, dhunës dhe përjashtimit.

4.8 Punëtorët socialë njohin se zhvillimi i strategjive për të thelluar vetëdijen kritike që sfidon dhe ndryshon supozimet e marrura si të mirëqena për veten dhe për njerëzit me të cilët angazhohemi, formon bazën e praktikës së përditshme etike dhe kundër-shtypëse.

5. Promovimi i të Drejtës për Pjesëmarrje

5.1 Punëtorët socialë punojnë për të ndërtuar vetëbesim dhe aftësitë e njerëzve, duke i ofruar burime për të marrë pjesë në mënyrë të plotë në shoqëritë e tyre, dhe promovimin e pjesëmarrjes së tyre të plotë dhe angazhimit në vendime dhe veprime që ndikojnë në jetën e tyre.

5.2 Punëtorët socialë kontribuojnë në krijimin e hapësirave dhe proceseve domethënëse për pjesëmarrjen e njerëzve në formulimin e politikave.

5.3 Punëtorët socialë promovojnë përfshirjen e njerëzve të cilët janë të përjashtuar nga pjesëmarrja ose përfitimi nga burimet për shkak të kriterëve të ndryshme të reflektuara në 3.1a.

6. Respektimi i Konfidencialitetit dhe Privatësisë

6.1 Punëtorët socialë respektojnë dhe punojnë në përputhje me të drejtat e njeriut për konfidencialitet dhe privatësi.

6.2 E drejta për konfidencialitet dhe privatësi mund të shkelën kur ka rrezik për dëm ndaj vetvetes ose të tjerëve.

6.3 Punëtorët socialë njohin se e drejta e një personi për konfidencialitet dhe privatësi është e kufizuar në disa rrethana ligjore.

6.4 Punëtorët socialë informojnë njerëzit me të cilët punojnë për kufizimet e tilla të konfidencialitetit dhe privatësisë.

6.5 Në disa kontekste kulturore, të karakterizuara me përqendrim-në-ne, në jetesën komunitare, Punëtorët socialë respektojnë dhe ndjekin të drejtën dhe zgjedhjen e njerëzve për konfidencialitet të bashkë-ndarë, në mënyrë që kjo të mos shkelë të drejtat e individëve.

7. Trajtimi i Njerëzve si Persona të Plotë

7.1 Punëtorët socialë njohin dimensionet biologjike, psikologjike, sociale, kulturore dhe shpirtërore të jetës së njerëzve, dhe kuptojnë dhe trajtojnë të gjithë njerëzit si persona të plotë. Kjo njohje përdoret për të formësuar vlerësime dhe ndërhyrje holistike, me pjesëmarrjen e plotë të njerëzve, organizatave dhe komuniteteve që angazhohen punëtorët socialë.

7.2 Punëtorët socialë bashkëpunojnë me anëtarët e ekipeve ndërdisiplinare për të arritur rezultate holistike dhe të favorshme.

8. Përdorimi Etik i Teknologjisë dhe Medias Sociale

8.1 Parimet etike të përcaktuara në këtë Deklaratë zbatohen në të gjitha kontekstet e praktikës, arsimin dhe kërkimin në fushën e punës sociale, qofshin ato në kontakt të drejtpërdrejtë *ballë-përballë* ose përdorimin e teknologjisë digjitale dhe medias sociale.

8.2 Punëtorët socialë njohin se përdorimi i teknologjisë digjitale dhe medias sociale mund të paraqesë kërcënime të veçanta për parimet e konfidencialitetit dhe privatësisë dhe duhet të marrin masat e nevojshme mbrojtje. Miratimi i informuar duhet të bëjë të qartë kufizimet e mundshme të konfidencialitetit dhe privatësisë.

8.3 Punëtorët socialë vlerësojnë se verifikimi i identitetit të përdoruesve të shërbimeve online, duke përfshirë moshën dhe vendndodhjen gjeografike mund të paraqesë një sfidë, për shembull, nëse janë të regjistruar dhe/ose të licensuar për të praktikë në një vend, kur përdoruesit online ndodhen jashtë jurisdiksionit, ose vështirësia për të siguruar që personi është në moshën madhore për të dhënë miratimin e informuar. Punëtorët socialë duhet të diskutojnë pasojat pragmatike dhe etike të çështjeve të tilla me bordet e tyre të regjistrimit dhe/ose licensimit.

8.4 Punëtorët socialë njohin rreziqet potenciale të komunikimit joekzistues, dhe të identiteteve të pa-verifikueshme të personave me të cilët ata punojnë, për shembull, synimet vetëvrasëse ose për vrasje, abuzim seksual i fëmijëve ose dhunë në familje. Këshillimi online nuk përjashton detyrimin e punëtorëve socialë për raportim, sipas kërkesave ligjore kombëtare, dhe për të mbrojtur personin ose të tjerët nga dëmtimi ose rreziku potencial.

8.5 Duke përdorur shërbimet e teknologjisë për punë grupore, punëtorët socialë sigurojnë që i përmbahen parimit të përfshirjes, dhe që askush nuk përjashtohet nga pjesëmarrja përmes mënjanimi të qëllimshëm.

8.6 Punëtorët socialë nuk postojnë foto të personave me të cilët ata punojnë pa miratimin e tyre, dhe ata nuk duhet të postojnë foto të fëmijëve pa miratimin e prindërve ose kujdestarëve ligjorë.

8.7 Në lidhje me arsimin në punën sociale, siç është reflektuar në 6.4 të Standardeve Globale për Arsim dhe Trajnimin në Punë Sociale, edukatorët duhet të sigurojnë cilësi të lartë të programit arsimor, pa marrë parasysh formën së ofrimit të programit të studimeve. Në rastin e mësimdhënies në distancë, mësimdhënies me modele të ndryshme, decentralizuar dhe/ose bazuar në internet, duhet të vendosen mekanizma për udhëzim dhe mentorim, veçanërisht në lidhje me komponentën e punës praktike në fushën e programit.

8.8 Është përgjegjësi e punëtorëve socialë të sigurojnë provë të praktikës etike, pavarësisht nga forma e praktikës.

9. Integriteti Profesional

9.1 Është përgjegjësi e asociacioneve dhe organizatave kombëtare të hartojnë dhe të përditësojnë kodet e tyre të etikës ose udhëzimet etike, në përputhje me këtë Deklaratë, duke marrë parasysh situatat lokale. Gjithashtu, është përgjegjësi e organizatave kombëtare të informojnë punëtorët socialë dhe shkollat e punës sociale për këtë Deklaratë të Parimeve Etike dhe udhëzimet e tyre etike. Punëtorët socialë duhet të veprojnë në përputhje me rregullat etike aktuale ose udhëzimet në vendin e tyre.

9.2 Punëtorët socialë duhet të kenë kualifikimet e nevojshme, dhe të zhvillojnë dhe mbajnë shkathhtësitë dhe kompetencat e nevojshme për të kryer punën e tyre.

9.3 Punëtorët socialë mbështesin paqen dhe jo dhunën. Ata mund të punojnë në bashkëpunim me personelin ushtarak për qëllime humanitare dhe të punojnë drejt ndërtimit të paqes dhe rindërtimit. Punëtorët socialë që operojnë në kontekstin ushtarak ose të ruajtjes së paqes duhet gjithmonë të mbështesin dinjitetin dhe agjencinë e njerëzve si qëllimi i tyre kryesor. Punëtorët socialë nuk duhet të lejojnë që njohuritë dhe aftësitë e tyre të përdoren për qëllime jo humanitare, si tortura, vëzhgimi ushtarak, terrorizmi, ose terapia e konvertimit, dhe nuk duhet të përdorin armë në kapacitetin e tyre profesional ose personal kundër njerëzve.

9.4 Punëtorët socialë duhet të veprojnë me integritet. Kjo përfshin mos-abuzimin e pozitës të fuqisë dhe marrëdhëniet e besimit me njerëzit që ata angazhohen; ata njohin kufijtë mes jetës personale dhe profesionale, dhe nuk abuzojnë me pozitën e tyre për përfitim material personal apo përfitim tjetër.

9.5 Punëtorët socialë njohin se dhënia dhe marrja e dhuratave të vogla është pjesë e përvojës së punës sociale dhe kulturore në disa kultura dhe vende. Në këto situata duhet të i referohen kodit etik të vendit.

9.6 Punëtorët socialë dhe punëdhënësit e tyre njohin nevojën për të ndërmarrë hapa për t'u kujdesur për veten profesionalisht dhe personalisht për të parandaluar *djegien profesionale* dhe për të përmirësuar marrëdhëniet dhe rezultatet e punës.

9.7 Punëtorët socialë pranojnë se ata janë përgjegjës për veprimet e tyre ndaj njerëzve me të cilët punojnë, kolegëve të tyre, punëdhënësve të tyre, asociacioneve profesionale, dhe ligjeve dhe konventave lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe që këto përgjegjësi mund të bien ndesh, të cilat duhet të koordinohen për të minimizuar dëmin për të gjithë personat. Vendimet duhet gjithmonë të bazohen në prova empirike, në mençurinë e praktikës, dhe në konsideratat etike, ligjore dhe kulturore. Punëtorët socialë duhet të jenë të gatshëm për të qenë transparentë rreth arsyeve në zgjedhjet e tyre.

9.8 Punëtorët socialë, dhe organizatat e tyre punëdhënëse, punojnë për të krijuar kushte në mjediset e tyre të punës dhe në vendet e tyre, ku parimet e kësaj Deklarate dhe ato të kodeve etike kombëtare të tyre diskutohen, vlerësohen dhe lartësohen. Punëtorët socialë dhe organizatat e tyre punëdhënëse nxisin dhe angazhohen në debate për të lehtësuar vendimet etike të informuara.